

Aktiviteti Institucional i FSHZH-së

# RAPORT VJETOR

## 2022



FONDI SHQIPTAR  
I ZHVILLIMIT

**SHKURTIME**

AEM	“Agjencia Ekonomike Mbështetëse - AEM” sh.p.k.
Agregatori	“AGREGATORI - Qendra për Zhvillim, Partneritet dhe Mirëqeverisje”
AK	Autoriteti Kontraktor
AMI	“Agjencia e Menaxhimit të Investimeve - AMI” sh.p.k.
AN	Akt Normativ
BB /WB	Banka Botërore /World Bank
BERZH /EBRD	Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim
BEI /EIB	Banka Europiane e Investimeve /European Investment Bank
BMZHR	Bordet e Monitorimit të Zhvillimit Rajonal
BNRZH /IBRD	Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim
DE	Drejtori Ekzekutiv
FSHZH /ADF	Fondi Shqiptar i Zhvillimit /Albanian Development Fund
FUZR	Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale
HUBEX	“HUBEX - Qendra e Ekselencës për Dije dhe Inovacion”
IPA	Instrumenti i Ndhmës së Paraaderimit
IVR	Infrastruktura Vendore Rajonale
KfW	Banka Gjermane për Zhvillim
KKZHRK	Komiteti Kombëtar për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin
KM	Këshilli i Ministrave
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MP	Manuali i Procedurave
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
NJVV	Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore
OE	Operator Ekonomik
OJF	Organizatë Jofitimprurëse
PBA	Projekt Buxheti Afatmesëm
PO 2028	Programi Operacional 2022 – 2028 i FSHZH
POZHRK	Programi Operacional i Zhvillimit Rajonal & Kohezionit
PZHIUT/ PIUTD	Projekti për Zhvillimin e Integruar Urban & Turistik/ Project for Integrated Urban and Tourism Development
QSH /GoA	Qeveria Shqiptare /Government of Albania
RDPA	Programi për Zhvillimin Rajonal në Shqipëri
VKD	Vendim i Këshillit Drejtues të FSHZH
WBIF	Western Balkans Investment Framework /Kudri i Investimeve për Ballkanin Perëndimor
ZHRK	Zhvillimi Rajonal & Kohezioni

HYRJE.....	4
1. REFORMA E ZHVILLIMIT RAJONAL DHE KOHEZIONIT .....	6
1.1. Kuadri strategjik për Zhvillimin Rajonal & Kohezionin .....	6
1.2. Kuadri rregullator për Zhvillimin Rajonal & Kohezionin .....	6
1.3. Kuadri institucional për Zhvillimin Rajonal & Kohezionin .....	7
2. SUPORTI ORGANIZATIV PËR ZHVILLIM RAJONAL & KOHEZION .....	9
2.1. Organizimi i ri strukturor .....	9
2.2. Procesi i detajimit të organizimit të brendshëm.....	10
3. GJENERIMI I ZHVILLIMIT RAJONAL DHE KOHEZIONIT .....	11
3.1. Programi Operacional 2022 - 2028.....	11
3.2. Formësimi (Thirrjet) dhe fizibiliteti i projekteve .....	12
3.3. Ecuria e programeve.....	13
3.4. Lëvrimi i produkteve .....	15
3.5. Realizimi i buxhetit.....	17
3.6. Procedurat e prokurimit .....	19
3.7. Rregullatori .....	20
4. TRANSFORMIMI I ZHVILLIMIT DHE KOHEZIONIT RAJONAL.....	21
4.1. Zhvillimi i aplikuar .....	21
4.2. Operatorët e shërbimeve .....	21
5. PËRPUTHSHMËRIA DHE TRANSPARENCA .....	24
5.1. Kontrolli dhe përputhshmëria e aktivitetit .....	24
5.2. Aktorët dhe partnerët për zhvillim.....	25
5.3. Transparenca dhe komunikimi me publikun .....	26

## HYRJE

Fondi Shqiptar i Zhvillimit është një organizatë me eksperiencë 30-vjeçare në zhvillimin e infrastrukturës, urbanizimit, turizmit dhe bashkëpunimit ndërkufitar, duke iu përgjigjur sfidave dhe partnerëve të saj, në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të vendit. FSHZH manaxhon një portofol vjetor operacionesh dhe programesh në vlerën rreth €200mln, me një ekip të përbërë prej mbi 160 profesionistësh të disiplinave të ndryshme, të pozicionuar në Tiranë dhe në 4 zyrat rajonale të zhvillimit në Shqipëri. Në përmbushjen e funksioneve dhe kompetencave sipas ligjit bazë nr. 10130, datë 11.5.2009, FSHZH synon përmirësimin e infrastrukturës social-ekonomike vendore, përmirësimin e shërbimeve publike vendore, forcimin institucional të NJVV-ve si dhe nxitjen e qeverisjes së mirë në nivel vendor.

Ligji 102/2020 “Për zhvillimin rajonal dhe kohezionin”, duke përcaktuar FSHZH-në si *Sekretariat* i Komitetit Kombëtar si dhe i Bordeve të Monitorimit, i ngarkon një rol kyç në përgatitjen e dokumenteve të planifikimit dhe programimit të zhvillimit rajonal nga njëra anë, dhe nga ana tjetër cakton FSHZH-në si *Autoritet Menaxhues* me përgjegjësinë për menaxhimin e programit operacional në përputhje me parimin e menaxhimit të qëndrueshëm financiar dhe arritjen e objektivave e treguesve të matshëm të tij. Ndaj, viti 2022 ka shënuar një zgjerim të rolit të FSHZH-së përgjatë gjithë ciklit të jetës së zhvillimit, si një organizatë që: (i) mbështet hartimin e politikave të zhvillimit rajonal; (ii) ka një rol aktiv në hartimin dhe zbatimin e planeve dhe programeve të zhvillimit; (iii) menaxhon dhe implementon në bashkëpunim me NJVV-të programet dhe projektet zhvillimore; (iv) mbështet hyrjen në treg si një operator zhvillimi, duke ngritur dhe vënë në funksionim modele të integruara zhvillimi në partneritet me njësitë vendore.

Për t’iu përshtatur këtyre ndryshimeve, gjatë vitit 2022 u rikonceptua ndarja e funksioneve dhe organizimi strukturor i FSHZH, duke ruajtur të njëjtin numër stafi.

Gjithashtu, për herë të parë në historinë e aktivitetit 30-vjeçar, u miratua “Programi Operacional 2022-2028” dhe detajimi i tij afatmesëm 2022-2024, nëpërmjet të cilëve FSHZH ka bërë një programim afatgjatë 7-vjeçar, të cilat reflektojnë edhe 5 drejtimet kryesore të veprimtarisë së FSHZH-së, duke mundësuar koordinim dhe sinergji më të madhe të investimeve dhe ndërhyrjeve në rajone, në funksion të një impakti sa më të lartë zhvillimor. Kjo në përputhje edhe me rolin si *Autoritet Manaxhues* të ngarkuar nga ligji. Në këtë program, të miratuar nga Këshilli Drejtues i FSHZH, është strukturuar, organizuar dhe integruar i gjithë aktiviteti i FSHZH në logjikë programatike, sipas disa drejtimeve kryesore dhe kategorive të ndërhyrjes.

“PO 2028” u parapri nga një proces konsultimi (thirrje), ku u propozuan rreth 500 projektide. Në vijim, me miratimin e Programit Operacional, u realizuan 3 thirrje për identifikim nevojash të NJVV & institucioneve publike, ku janë paraqitur 322 aplikime. Si rezultat, në zbatim të “PO 2028” janë formësuar rreth 214 projekte të shpërndarë në të katër rajonet, nga të cilat 25 me financim të huaj dhe 189 me financim nga Buxheti i Shtetit.

Janë menaxhuar 15 programe (rreth 400 kontrata), prej të cilëve 11 janë me financim të huaj (rreth 5.9 miliardë ALL), 3 me financim të brendshëm (rreth 8.2 miliardë ALL), si edhe ai i rindërtimit me rreth 7.83 miliardë lekë. Ecuria e programeve në zbatim arrin në vlerën 23.4 miliardë Lekë.

Janë rehabilituar 454km rrugë, 218 km ujësjellës dhe kanalizime, 163 ml nyje lidhëse Ura, 231'495 m<sup>2</sup> rikonstrukcion fasadash, 106 ha sipërfaqe sheshesh në blloqe banimi, si dhe 438 objekte (banesa kolektive & banesa individuale) të reja për Programin e Rindërtimit. Janë kontrolluar 71 projekte zhvillimi, nga të cilat janë miratuar mbi 80% të tyre dhe kanë vijuar procesin e detajimit dhe prokurimit. FSHZH ka siguruar oponencë teknike për 48 projekte zbatimi. Është përgatitur dokumentacioni dhe është aplikuar për pajisjen me lejet e kërkuara nga legjislacioni në fuqi për 111 objekte (75 leje të miratuara dhe 36 në proces). Për 539 objekte ku kanë përfunduar punimet, u dorëzuan 9 objekte tek NJVV duke nënshkruar Certifikatat e Marrjes në Dorëzim Përfundimtar dhe 515 objekte me Certifikatat e Marrjes në Dorëzim të Përkohshëm. Referuar Programit të Rindërtimit, u transferua investimi në NJVV sipas VKM-ve përkatëse për 93 objekte.

Në total, buxheti 2022 është realizuar në masën 99.41% dhe janë kryer mbi 6,000 transaksione financiare. Duke konsideruar ndryshimet nga aktet normative apo vendimet e Këshillit të Ministrave, buxheti i rishikuar i FSHZH-së bëhet 23.56 miliardë lekë nga të cilat realizuar 23.42 miliardë lekë, ndarë sipas programeve: (i) me Financim të Huaj 5.89 miliardë ALL; (ii) me Financim të Brendshëm 9.69 miliardë ALL; (iii) Programi i Rindërtimit 7.83 miliardë ALL.

Mbi 260 procedura prokurimi janë ndjekur dhe zhvilluar, ku vlera e kontratave të nënshkuara gjatë vitit 2022 rezulton në total 21,5 mld lekë me tvsh. Rreth 51% të kësaj vlere, e zënë kontratat në zbatim të programit të investimeve të QSH dhe rreth 49% kontratat në zbatim të programeve me financim të huaj. Nga Fondi Limit prej rreth 28.55 mld Lekë me tvsh, janë kursyer rreth 7.05 mld lekë me tvsh, të cilat përbëjnë rreth 24.7% të fondit total të shpallur për tenderim.

FSHZH, përmes ngritjes së posaçme të Departamentit të Zhvillimit Rajonal & Kohezionit, me mbështetjen e RDPA, përgjatë 2022 është angazhuar për çuarjen përpara të Reformës së Zhvillimit Rajonal. Impakt pozitiv ka dhënë vizita studimore pranë Komisionit Europian në Bruksel (si pjesë e grupit ndër-institucional të punës për përgatitjen e negociatave për Kapitullin 22); pjesëmarrja në takimin e 13 të Nënkomitetit të Bashkimit Europian – Shqipëri “Transport, Energji, Mjedis dhe Zhvillimit Rajonal”; si dhe një sërë trajnimesh mbi politikën dhe kuadrin ligjor të BE-së.

Dokumentet planifikues dhe programues në nivel kombëtar në zbatim të ligjit 102/2020, duhet fillimisht të miratohen nga KKZHRK (*pritet Urdhëri i Kryeministrit për përcaktimin e anëtarëve*) dhe më pas nga KM, me këtë rend kronologjik: (i) Politika Kombëtare për ZHRK - *draftuar/proces konsultimi*; (ii) Plani Kombëtar; (iii) Planet Rajonale; (iv) Programi Operacional. Referuar akteve nënligjore në zbatim të ligjit 102/2020, rezulton se në vitin 2022, është miratuar 1 akt, ndërsa 8 të tjerë janë në proces (*3 në fazë miratimi, 3 në fazë konsultimi, 2 akte në finalizim draftimi*).

Gjatë vitit 2022 janë realizuar disa modele të zhvillimit të aplikuar si produkt i departamentit të ri të ngritur për këtë qëllim, duke rezultuar në projekte transformuese dhe inovatore që nxisin zhvillimin e modeleve të reja të suksesshme. Duke u mbështetur në eksperiencën e tri dekadave, FSHZH-ja po hyn në një cikël të ri të zhvillimit dhe funksionimit, referuar jo vetëm veprimtarisë së organizatës por edhe subjekteve të saj (*AEM, AMI, HUBEX, Agregatori*) të cilët tashmë janë ngritur sipas vendimeve të Këshillit Drejtues dhe gjenden në proces konsolidimi.

## 1. REFORMA E ZHVILLIMIT RAJONAL DHE KOHEZIONIT

### 1.1. KUADRI STRATEGJIK PËR ZHVILLIMIN RAJONAL & KOHEZIONIN

Politikat për zhvillim rajonal dhe kohezion, optimizimi i kuadrit ligjor dhe institucional për zbatimin e Reformës së Zhvillimit Rajonal, vijuan të jenë ndër prioritetet kryesore të Qeverisë Shqiptare dhe të veprimtarisë së FSHZH-së edhe për vitin 2022. Zbatimi i kësaj reforme vjen si nevojë e brendshme për zhvillim koheziv kombëtar, koordinim më të mirë horizontal e vertikal të politikave sektoriale dhe lokale, por edhe si pjesë e detyrimit për përmbushjen e kërkesave për anëtarësim në BE, që lidhen drejtpërdrejt me Kapitullin 22 “Politikat Rajonale dhe Koordinimi i Instrumenteve Strukturore” të negociatave të anëtarësimit.

Gjatë 2022, FSHZH ka hartuar draft Politikën Kombëtare të Zhvillimit Rajonal dhe Kohezionit, pas konsultimit të ngushtë me aktorët kryesorë (si ministrinë që mbulojnë sektorët kryesorë, NJVV-të, bizneset, OJF-të dhe partnerë të tjerë socio-ekonomikë). Për shkak të kompleksitetit të politikës dhe numrit të madh të grupeve të interesit që përfshihen, procesi i konsultimit vazhdon dhe draft dokumenti pritet të kalojë për miratim në organet përgjegjëse përgjatë 2023. Mbi bazë të këtij dokumenti, do të hartohen Plani Kombëtar për ZHRK, katër Planet Rajonale të zhvillimit, Programi Operacional, dhe në vijim shpërndahen fondet që adresojnë zhvillimin rajonal në Shqipëri.

Paralelisht me mbështetjen për draftimin e Politikës Kombëtare të ZHRK, është punuar për përgatitjen e një indeksi mbi strukturën/kornizën e Planit Kombëtar dhe Planeve Rajonale si dhe në draftimin e kapitujve mbi përshkrimin e situatës dhe analizën e pabarazive mes rajoneve.

**Kapitulli 22 “Politikat Rajonale dhe Koordinimi i Instrumenteve Strukturore”:** përgjatë 2022, është realizuar një vizitë studimore pranë Komisionit Europian në Bruksel, si pjesë e grupit ndërinstitucional të punës për përgatitjen e negociatave për Kapitullin 22, si dhe pjesëmarrja në takimin e 13-të të Nënkomitetit të Bashkimit Europian – Shqipëri “*Transport, Energji, Mjedis dhe Zhvillim Rajonal*”, ku u prezantua progresi i arritur në kuadrin planifikues të Kapitullit 22. Për më tepër, përgjatë vitit të kaluar janë kryer një sërë trajnimesh si dhe janë hartuar raporte informues mbi komponentët përbërës të politikës së kohezionit & kuadrit ligjor të BE-së, me qëllim njohjen dhe përthithjen e njohurive mbi fondet strukturore dhe parimet e politikës së kohezionit. Konkretisht: (i) përmbledhje e rregullores së BE CPR1060/2021, shoqëruar me analizë të komponentëve të saj; (ii) krijimi i një manuali gjithëpërfshirës të politikës së kohezionit të BE-së, si dhe analizë krahasimore midis vendeve të rajonit dhe statusit të negociatave në lidhje me kapitullin 22; (iii) trajnime mbi historikun dhe përmbajtjen e Kapitullit 22 nga RDPA dhe ekspertë të fushës; (iv) raportime javore mbi aktivitetin e zhvilluar në kuadër të kapitullit 22, drejtuar sekretariatit teknik të GNPIE (Agjencisë së Mbështetjes së Vetëqeverisjes Vendore).

### 1.2. KUADRI RREGULLATOR PËR ZHVILLIMIN RAJONAL & KOHEZIONIN

Gjatë 2022, FSHZH është angazhuar në optimizimin e kuadrit rregullator, institucional dhe strategjik, në zbatim të rolit të saj sipas ligjit nr. 102/2020 “Për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin”, në zbatim të të cilit duhet të dalin një sërë aktesh nënligjore. Në këtë drejtim është punuar për hartimin, konsultimin, reflektimin e komenteve/sugjerimeve, përmirësimin dhe ndjekjen e procesit

të miratimit të këtyre akteve, të cilat janë në faza të ndryshme të procesit (1 akt i miratuar dhe 8 akte në proces të avancuar), si vijon:

- 1 akt i miratuar
  - VKM nr. 497, datë 27.07.2022, “Për krijimin, përbërjen, organizimin, veprimtarinë dhe rregullat e funksionimit të Komitetit Kombëtar për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin”;
- 3 akte në proces miratimi (procesi është iniciuar nga Zyra e Zëvendëskryeministrit)
  - pVKM “Për përcaktimin e përbërjes, organizimin, veprimtarinë dhe procedurave për krijimin dhe funksionimin e Bordeve të Monitorimit të Zhvillimit Rajonal”;
  - pVKM “Për përcatimin e procedurave për hartimin e Planit Kombëtar dhe Planeve Rajonale për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin”;
  - draft Urdhër i Kryeministrit për caktimin e anëtarëve të KKZHRK-së, përfaqësues të ministrive sipas fushës së përgjegjësisë;
- 3 akte në fazë përmbyllëse (në procesin e konsultimeve konkluduese dhe kontrollit të cilësisë përpara inicimit të procesit të miratimit nga KM)
  - pVKM “Për përcaktimin e procedurave për hartimin e Programit Operacional për zhvillimin rajonal” (POZHRK);
  - pVKM “Për përcaktimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Menaxhues, Organeve të Ndërmjetme si dhe rregullave të përgjithshme për Sistemin e menaxhimit dhe kontrollit të Programit Operacional të zhvillimit rajonal dhe kohezionit dhe sistemet përkatëse të menaxhimit për zbatimin e funksioneve të deleguara”;
  - pVKM “Për përcaktimin e kushteve dhe procedurave për përdorimin e burimeve financiare të fondit për zhvillimin rajonal”;
- 2 akte në proces hartimi (është punuar për përgatitjen e draftit)
  - pVKM “Për përcaktimin kushteve dhe procedurave për ngritjen e bazës së të dhënave për zhvillimin rajonal, kategoritë e të dhënave dhe institucionet përgjegjëse”;
  - draft Rregullore e brendshme për funksionimin e KKZHRK-së (nga pikëpamja administrative dhe teknike).

### 1.3. KUADRI INSTITUCIONAL PËR ZHVILLIMIN RAJONAL & KOHEZIONIN

Gjatë 2022, është punuar në drejtim të forcimit të kuadrit institucional të ZHRK dhe ngritjes së kapaciteteve, në lidhje me zhvillimin rajonal dhe kohezionin.

Si rezultat, referuar fillimisht FSHZH-së (duke konsideruar përgjegjësitë dhe funksionet e reja nga ligji për zhvillimin rajonal dhe kohezionin), lindi si domosdoshmëri transformimi i organizatës, proces i cili u realizua gjatë vitit 2022 nëpërmjet strukturës së re organizative në FSHZH duke orientuar të gjithë FSHZH në këtë drejtim dhe për efekt të këtij qëllimi. Ky transformim përfshiu ngritjen e posaçme të Departamentit të Zhvillimit Rajonal & Kohezionit, me mbështetjen e RDPA përgjatë vitit 2022, strukturë e cila është angazhuar në drejtim të politikëbërjes për çuarjen përpara të reformës për zhvillimin rajonal, përgatitjen e kuadrit strategjik, angazhimin e aktorëve, përgatitjen e kuadrit nënligjor përkatës, krijimin e institucioneve mbështetëse të zhvillimit rajonal, dhënien e inputeve në mbështetje të programimit të ndërhyrjeve dhe investimeve. Siç detajohet në këtë raport, transformimi i organizatës përfshin orientimin drejt zhvillimit ekonomik duke



ndërtuar modele ekonomike inovative dhe partneritete, të aftë për të çliruar potenciale zhvillimore të suksesshëm dhe që gjenerojnë sinergji ndërmjet aktorëve.

Në 2022 është punuar në drejtim të forcimit të kuadrit institucional edhe duke u fokusuar tek NJVV-të, me ndikim në organizimin strukturor të tyre dhe ngritjen e kapaciteteve. Konkretisht FSHZH ka formësuar dhe aplikuar një program të dedikuar për fuqizimin e bashkive (pjesë e drejtimeve dhe ndërhyrjeve të Programit Operacional 2022-2028 dhe detajimit të tij afatmesëm 3-vjeçar 2022-2024), duke përfshirë si komponentë të tij aplikimin nëpërmjet thirrjeve të ndryshme për paraqitje popozimesh dhe projektesh, duke bërë të mundur marrjen e një roli aktiv nga vetë bashkitë, me qëllim final ngritjen e kapaciteteve projektuese të vetë NJVV-ve.

Rol të rëndësishëm ka luajtur këtu Programi për Zhvillimin Rajonal në Shqipëri (RDPA), duke nënvizuar edhe aplikimin e dy skemave të granteve me njësitë e vetëqeverisjes vendore. Dhënia e një roli të drejtpërdrejtë aktiv bashkive të përfshira në 10 projektet e financuara së fundi (ku vetëm njëri është ende në vazhdim me Bashkinë Gjirokastrë deri më 31.03.2023), rezultoi shumë e suksesshme dhe kontriboi në ngritjen dhe fuqizimin e kapaciteteve menaxheriale të NJVV-ve.

Referuar punës për ngritjen e KKZHRK-së dhe BMZHRK-ve sipas kërkesave të ligjit 102/2020, FSHZH (Departamenti i Zhvillimit Rajonal & Kohezionit) ka punuar në drejtim të krijimit të partneriteteve, duke përfshirë realizimin e takimeve të ndryshme për këtë qëllim:

- Konkretisht, është bërë vlerësimi për qarkun me numrin më të madh të popullsisë për secilin rajon, për efekt të përzgjedhjes së anëtarëve të KKZHRK-së gjatë periudhës tranzitore deri në ngritjen e BMZHR-ve.
- Ligji parashikon që BMZHR-të janë organe të përbashkët të NJVV-ve dhe subjekteve të tjerë përgjegjës në zhvillimin rajonal përkatës, që mundësojnë përgatitjen dhe monitorimin e dokumenteve të planifikimit dhe programimit për zbatimin e politikës së ZHRK në rajonin konkret. Pjesa më e madhe e anëtarëve janë përfaqësues të vetëqeverisjes vendore, pjesa tjetër janë nga shoqëria civile, sektori privat, media si dhe bota akademike. Rolin e sekretariatit teknik të BMZHR-ve e luajnë Zyrat Rajonale përkatëse të FSHZH-së (inkuadruar brenda Departamentit të ZHRK).

Ndaj, gjatë vitit 2022, në funksion të ngritjes së BMZHR-ve dhe ndërgjegjësimi të aktorëve mbi rolin e tyre në këtë kuadër, u zhvilluan disa takime konsultimi në dy qarqe – pjesë e Rajonit 1 dhe Rajonit 13, ku pjesëmarrësit (përfaqësues të partnerëve socio-ekonomikë) dhanë kontribut në konceptimin e procesit të përzgjedhjes së anëtarëve të BMZHR-ve, duke shërbyer edhe për njohjen dhe bashkëpunimin e mëtejshëm ndërmjet aktorëve të ZHRK-së si dhe funksionimin e BMZHR-së në rajonin përkatës.



## 2. SUPORTI ORGANIZATIV PËR ZHVILLIM RAJONAL & KOHEZION

### 2.1. ORGANIZIMI I RI STRUKTUROR

Në kuadër të zhvillimit të veprimtarisë së FSHZH-së me përgjegjësitë dhe funksionet e reja sipas Ligjit për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin, portofolit të rritur dhe të diversifikuar, volumit të shtuar të punës, nevojës për ngritje kapacitetesh, orientimit drejt zhvillimit ekonomik duke ndërtuar modele ekonomike inovative dhe partneritete, lindi si domosdoshmëri transformimi i organizatës.

Në fillim të vitit 2022 u përgatit, miratua dhe filloi zbatimin e strukturës së re organizative në FSHZH, duke pasur si objektiva kryesore për t'u përmbushur:

- transformimin e FSHZH-së në një organizatë të aftë për të çliruar potenciale zhvillimore përmes përgatitjes dhe zbatimit të dokumenteve planifikues për zhvillimin e rajoneve në përputhje me vizionin dhe strategjitë kombëtare të qeverisë shqiptare;
- zgjerimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të aftësive planifikuese dhe programuese;
- përgatitjen e modeleve zhvillimore të suksesshëm;
- optimizimi i burimeve njerëzore dhe financiare si dhe forcimi i sinergjisë mes aktorëve.

Struktura e re, por me të njëjtin numër stafi prej 164 punonjësish, u konceptua sipas ndarjes në 5 funksione kryesore: (i) *funkzioni ekzekutiv*, për orientimin e organizatës drejt objektivave strategjikë; (ii) *funkzioni i zhvillimit rajonal dhe kohezionit*, orientuar drejt ndërtimit dhe jetëzimit të sistemit të ZHRK, implementimit të strategjisë dhe politikave për zhvillimin e rajoneve; (iii) *funkcionimi i brendshëm i organizatës*, për garantimin e aktiviteteve jetike për mirëfunksionimin e organizatës nëpërmjet menaxhimit: financiar, të prokurimeve dhe kontratave, përputhshmërisë ligjore dhe rregullatore, organizimit të brendshëm dhe burimeve njerëzore; (iv) *funkzioni i programimit strategjik dhe lëvrimin të produkteve*, duke përfshirë edhe formësimin dhe fizibilitetin e projekteve, së bashku me menaxhimin e programeve/ projekteve; si dhe (v) *funkzioni i zhvillimit të aplikuar dhe partneritetit*, mbi ndërtimin e modeleve, duke filluar nga investimi i aseteve e deri tek krijimi i partneriteteve me bashkitë, etj.

Gjatë vitit 2022 është punuar në disa drejtime për të kontribuar në përmbushjen e këtyre objektivave, konkretisht:

- Është përgatitur “MP-Organizimi Struktural i FSHZH” në të cilin janë përcaktuar vizioni, misioni, parimet e punës, funksionet, politikat e punës, linjat e komunikim/raportimit (*si brenda departamentit apo drejtorisë por edhe midis tyre*) dhe vendimarrja.
- Në përputhje me organigramën e re u përcaktuan pozicionet e punës (*pozicionet drejtuese dhe specialistët*) për çdo departament, drejtori dhe qendër. Janë përcaktuar pozicione të reja si dhe janë rishikuar pozicionet ekzistuese duke i përshtatur me strukturën e re organizative.
- Mbështetur në objektivat dhe politikat e punës, janë përcaktuar funksionet dhe aktivitetet e brendshme, si dhe detyrat që do të realizohen nga çdo departament, drejtori dhe qendër. Në vijim, në përputhje me përcaktimin e aktivitetit dhe funksioneve të brendshme, janë

hartuar kërkesat për çdo vend pune dhe bashkë me to edhe përshkrimet e punës për çdo pozicion, proces i cili do të vazhdojë edhe gjatë vitit 2023.

- Pavarësisht se strukturimi i ri nuk ndryshonte numrin total prej 164 punonjësish, në mënyrë që struktura e re organizative të bëhej funksionale, u analizua dhe zbatua qarkullimi i brendshëm i punonjësve ekzistues duke synuar të vendosen punonjësit e duhur në vendet e përshtatshme të punës. Për 2022 rezultoi se moshë mesatare e personave të punësuar në organizatë është 43 vjeç, ndërsa referuar aspektit gjinor 56% e stafit janë femra.
- Është rishikuar dhe përmirësuar metodologjia e vlerësimit të performancës në punë të punonjësve me qëllim që procesi të jetë sa më objektiv, efektiv dhe transparent, si dhe të shërbejë në planifikimin e trajnimeve për rritjen e aftësive profesionale në punë të punonjësve në FSHZH.
- Gjatë vitit 2022 është organizuar testimi i punonjësve për të matur dhe vlerësuar nivelin e përdorimit të teknologjisë informatike në punë si dhe për të orientuar politikën e reja të trajnimit. Bazuar në këto rezultate, nga specialistët të brendshëm të fushës së IT janë kryer seanca trajnimi në nivele të ndryshme të teknologjisë së informacionit për punonjësit.

## 2.2. PROCESI I DETAJIMIT TË ORGANIZIMIT TË BRENDSHËM

Vitin e kaluar është bashkëpunuar me departamentet/drejtoritë për përcaktimin e proceseve të punës, të detyrave dhe përgjegjësive që kanë, rolet/specialistët që do i kryejnë këto procese në përputhje me objektivat, funksionet dhe aktivitetin kryesor, si dhe për përgatitjen e organizimit të brendshëm të funksionimit për çdo departament, drejtori, zyrë, specialist. Ky proces do të vazhdojë edhe gjatë vitit 2023 për finalizimin e të gjithë aktivitetit të FSHZH-së.

Lidhur me organizimin e brendshëm, në kuadër të implementimit të shërbimeve *outsourcing* është punuar për të transferuar disa prej proceseve që kryhen në organizatë tek subjektet e themeluara/ngritura nga FSHZH sipas vendimeve të Këshillit Drejtues për objektin e veprimtarisë së tyre. Për këtë u analizuan në mënyrë të detajuar proceset e lidhura me ofrimin e këtyre shërbimeve, si në aspektin operacional ashtu edhe në pjesën financiare. Në përfundim është konkluduar që këto procese të transferohen tek këta operatorë ekonomikë të FSHZH-së dhe shërbimet të kryhen prej tyre, duke e orientuar aktivitetin e brendshëm drejt menaxhimit dhe monitorimit më të mirë të kërkesave të punonjësve për këto shërbime si dhe duke siguruar shërbime cilësore dhe me efektivitet.

### 3. GJENERIMI I ZHVILLIMIT RAJONAL DHE KOHEZIONIT

#### 3.1. PROGRAMI OPERACIONAL 2022 - 2028

Në kuadër të Reformës së Qeverisë Shqiptare për Zhvillimin Rajonal, ligjit nr. 102/2020 “Për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin” si dhe ligjit nr. 10 130, datë 11.5.2009, “Për Fondin Shqiptar të Zhvillimit” (i ndryshuar), FSHZH gjatë vitit 2022, përgatiti Programin Operacional 7-vjeçar të aktivitetit të institucionit, i cili u miratua nga Këshilli Drejtues i FSHZH me vendimin nr. 225, datë 23.3.2022.

PO 2022-2028, është risi për FSHZH, pasi për herë të parë në historinë e aktivitetit të tij 30-vjeçar, organizon në një planifikim operacional 7-vjeçar objektivat strategjike të institucionit, politikën e Qeverisë së Shqipërisë për zhvillimin social-ekonomik, drejtimet e zhvillimit rajonal dhe kohezionit, siç janë përcaktuar në ligjin 102/2020, si dhe programet aktive në zbatim dhe ato të dakorduara.

Programi Operacional 2022-2028 i FSHZH-së, paraqet 5 drejtimet kryesore ku do të fokusohen ndërhyrjet transformuese në përmbushje të objektivave strategjike të zhvillimit rajonal:

1. Transformimi i infrastrukturës rajonale dhe vendore;
2. Energjizimi dhe zhvillimi i kapaciteteve shërbyese të NJVV;
3. Inovacioni dhe energjizimi i aktivitetit prodhues;
4. Rritja e ndërveprimit social dhe krijimi i sinergjisë mes grupeve të interesit;
5. Transformimi i kapitalit njerëzor dhe qendrave të dijes.

Buxheti 7-vjeçar i PO është rreth 100 miliardë Lekë dhe parashikon financimin nga Buxheti i Shtetit, Financimi i huaj, Fonde të BE-së si dhe bashkëfinancim nga përfituesit.

Në kuadër të programimit strategjik të aktivitetit të FSHZH, gjatë vitit 2022, është realizuar:

- Detajimi 3-vjeçar i PO, konkretisht për vitet 2022-2024 (miratuar me vendimin nr. 231, datë 4.5.2022, të Këshillit Drejtues të FSHZH);
- Draftimi i Pilotimit dhe Programit të Ndërhyrjes “Transformimi dhe Fuqizimi i Sistemit të Ndërtimit dhe Mirëmbajtjes së Rrjetit Rrugor Rural”;
- Angazhimi i programeve të reja të financimit dhe ndërhyrjes si pjesë e PO (“Programi për Zhvillimin e Integruar Rajonal” financuar nga KfW, Porta Bregdetare e Alpeve financuar nga BEI);
- Konceptimi i strukturës dhe mënyrës së funksionimit të Sistemit të Arkivimit dhe shpërndarjes së Studimeve/Raporteve/Analizave;
- Analiza në kuadër të hartimit të programeve të ndërhyrjeve.
- Finalizimi i dy studimeve të vlerësimit të impaktit në kuader të Programit “100 Fshatrat” dhe PZHIUT.

### 3.2. FORMËSIMI (THIRRJET) DHE FIZIBILITETI I PROJEKTEVE

Për të garantuar formësimin dhe fizibilitetin e projekteve të të gjitha iniciativave dhe aplikimeve që jetësojnë zhvillim ekonomik dhe social në rajon, duke u mbështetur në PO 2028, dokumentet strategjike, planifikues, në gjetjet nga analizat dhe studimet e kryera, si dhe në kërkesat e ardhura nga NJVV, OJF, Biznese, Ministri/Agjenci Publike dhe Bota Akademike, duke përdorur qasjen ‘bottom-up approach’, gjatë vitit 2022 është kryer:

- 1 THIRRJE për konsultim publik dhe ide në funksion të përgatitjes së paketave të investimit për PO 2022-2028, në të cilën janë propozuar rreth 500 projekt-ide;
- 3 THIRRJE për identifikim nevojash për:
  - Shtresat rrugore, në të cilën kanë ardhur 186 aplikime;
  - Materialet e ndërtimit, në të cilën kanë ardhur 127 aplikime;
  - Paisje me panele fotovoltaike në tarracat e godinave të institucioneve publike, në të cilën kanë ardhur 9 aplikime.

Këto thirrje janë realizuar përmes publikimeve në website-in zyrtar të FSHZH dhe nëpërmjet adresës elektronike të FSHZH, si dhe janë përforcuar nëpërmjet rrjeteve sociale të tjera (Facebook, Instagram, etj.).

Për aplikimet e propozuara nëpërmjet thirrjeve, është zbatuar metodologjia e prioritizimit, e cila ka qëllim kryesor përzgjedhjen e projekteve prioritare të qëndrueshëm, strategjike, fizibël, të integruar dhe gjithëpërfshirës. Kriteret për përcaktimin e projekteve prioritare janë: (i) rëndësia dhe koherenca strategjike; (ii) kontributi në zhvillimin e balancuar territorial dhe ndikimin social-ekonomik; (iii) ndikimi në mjedis; (iv) potenciali për të kontribuar në investimet private për zhvillimin ekonomik; (v) fizibiliteti i zbatimit; (vi) mbështetja e palëve të interesuara dhe partneriteti.

Si rezultat i këtij procesi, gjatë vitit 2022 u formësuan rreth 214 projekte, nga të cilat 25 me financim të huaj dhe 189 me financim nga Buxheti i Shtetit. Gjithashtu, janë përgatitur 4 aplikime për projekte të reja në Programet CBC me financim IPA.

Formësimi sipas drejtimeve të Programit Operacional, paraqitet si më poshtë:

**Drejtimi 1** – janë formësuar 109 projekte, në vlerën 13,001,365,000 ALL (përkundrejt 17,123,940,000 ALL të programuara).


Të ndara në rajone:

Rajoni 1 – 17 projekte

Rajoni 2 – 39 projekte

Rajoni 3 – 22 projekte

Rajoni 4 – 31 projekte



**Drejtimi 2** – janë formësuar **79 projekte**, në vlerën 1,100,000,000 ALL (përkundrejt 1,350,000,000 ALL të programuara). Ky drejtim ka si qëllim aftësimin e bashkive për menaxhuar asetet, për të rritur të ardhurat, rikonceptuar modelin për mirëmbajtjen, ngritjen e strukturave ekonomike, etj.

Në këtë drejtim janë shpallur fituese 77 projekte për furnizim me lëndë të parë pune dhe materiale ndërtimi nga 127 aplikime të paraqitura, të shtrira në 21 bashki përfituese, 14 prej të cilave janë bashki të vogla, si dhe 2 ndërhyrje të tjera për mbështetjen e bashkive me makineri dhe me procesin e regjistrimit fillestar të pronave në fshatrat turistike.

**Drejtimi 4** – nga 2 ndërhyrje të parashikuara, është formësuar 1 projekt “Ndërhyrje për mbështetjen e aktivitetit dhe eventeve sociale në bashkëpunim me NJVV” me vlerë 180 mln Lekë, dhe ndërkohë që është në proces formësimi edhe ndërhyrja tjetër e parashikuar në detajimin 3-vjeçar të Programit Operacional.


Si rezultat, për projektet me financim të brendshëm, janë formësuar në total 189 projekte në vlerën 14,281,365,000 ALL.

### 3.3. ECURIA E PROGRAMEVE

Për vitin 2022 janë menaxhuar në kohë rreth 400 kontrata për të gjithë programet e financimit dhe ecuria e programeve në zbatim arrin në vlerën 23,422,334,270 Lekë ose në masën 99.41% e shpërndarë sipas komponentëve të secilit program.


► Menaxhimi i 11 programeve me financim të huaj është realizuar në kohë dhe me cilësi, në vlerë 5,896,346,138 Lekë dhe është realizuar në masën 100% kundrejt buxhetit të miratuar, si vijon:

- Programi i Zhvillimit Rajonal në vlerën 10,000,000 ALL;
- Programi për Rindërtim dhe Zhvillim në Zonat e Prekura nga Tërmeti, realizuar në vlerën 272,486,235 ALL;
- IPA ADRION në vlerën 8,987,114 ALL;
- ALMONIT realizuar në vlerën 64,290,271 ALL;
- Mbështetje për sistemimin e Furnizimit me Ujë të Zonave Rurale III, realizuar në vlerën 162,538,513 ALL;
- Mbështetje për sistemimin e furnizimit me Ujë të Zonave Rurale IV, realizuar në vlerën 820,221,218 ALL dhe është në proces zbatimi;
- Projekti për Zhvillimin e Integruar të Zonave me Potencial Turistik realizuar në vlerën 1,275,135,286 ALL;
- Programi për Zhvillimin e Turizmit (TLED) realizuar në vlerën 656,337,529 ALL;
- Programi i Rrugëve Rurale (BB) në vlerën 898,243,821 ALL;
- Programi i Rrugëve Rurale (BERZH) në vlerën 330,916,930 ALL;
- Programi i Rehabilitimit të Lumit të Vlorës realizuar në vlerën 1,397,189,221 ALL.




► Menaxhimi i 3 programeve me financim të brendshëm është realizuar në kohë dhe me cilësi, në vlerë 8,183,189,370 Lekë, si vijon:

- Programi “100 fshatrat” - në vlerën 100,000,000 ALL;
- Programi i Qeverisjes Vendore dhe Rajonale – në vlerën 3,012,138,783 ALL;
- Programi GOA – në vlerën 5,071,050,587 ALL.



► Menaxhimi i Programit të Rindërtimit në vlerën 7,832,855,458 ALL



## SHËNDETI, SIGURIA, MJEDISI DHE PËRGJEGJËSIA SOCIALE

Përgjatë vitit 2022, është monitoruar aspekti mjedisor dhe social për 195 objekte, si dhe janë kontrolluar dhe inspektuar mbi sigurinë dhe shëndetin në punë 108 objekte, përkatësisht të detajuar sipas programeve listuar në tabelën e mëposhtme:

Nr	Programi	Monitorime në terren	
		Mjedis & Sociale	Shëndeti & Siguria
1	Programi i Rindërtimit	61	87
2	Projekte me financim nga Buxheti i Shtetit	100	16
3	PZHIUT - Programi i Zhvillimit të Integruar Urban dhe Turizmit	16	2
4	PRLRP - Programi i Rrugëve Lidhëse Rajonale dhe Lokale	14	3
5	Programi i Turizmit (AITP)	2	-
6	IPA (molet Shirokë)	2	-
<b>TOTALI</b>		<b>195 vizita</b>	<b>108 vizita</b>

### 3.4. LËVRIMI I PRODUKTEVE

Gjatë vitit 2022 është garantuar lëvrimi i produkteve finale të projekteve tek përfituesi, në afatin, cilësinë dhe dokumentacionin e duhur, në përputhje me specifikimet teknike, kushtet e kontratës dhe kriteret e përcaktuara nga donatorët.

Janë rehabilituar 454km rrugë, 218km ujësjellës dhe kanalizime, 163ml nyje lidhëse Ura, 231'495m<sup>2</sup> rikonstruksion fasadash, 106ha sipërfaqe sheshesh në blloqe banimi, si dhe 438 objekte (banesa kolektive & banesa individuale) të reja për Programin e Rindërtimit.

#### ► Projektimi, miratimi & lejet për zhvillim

Gjatë vitit 2022 janë kontrolluar **71 projekte** zhvillimi, sipas përcaktimeve të programeve të FSHZH-së, nga të cilat mbi 80% të tyre të miratuara dhe kanë vijuar procesin e detajimit dhe prokurimit, përkatësisht:

- *Programi i Ndërrhyrjeve të Financuara nga Buxheti i Shtetit (GoA & IVR): me 52 objekte, nga të cilët të miratuar për procesin e detajimit dhe prokurimit 39 objekte;*
- *Programi i Zhvillimit të Integruar Urban dhe Turizmit (PZHIUT): me 11 objekte të kontrolluara dhe miratuara për procesin e detajimit dhe prokurimit;*
- *Programi për Rindërtim dhe Zhvillim në Zonat e Prekura nga Tërmeti: me 8 objekte të kontrolluara dhe miratuara për procesin e detajimit dhe prokurimit.*

Gjithashtu, për të garantuar cilësinë si dhe certifikimin e projekteve, FSHZH ka siguruar **oponencë teknike** nga institucionet përkatëse për rreth **48 projekte zbatimi**:

- *Programi i Ndërrhyrjeve të Financuara nga Buxheti i Shtetit (GoA & IVR): me 27 projekte;*
- *Programi i Zhvillimit të Integruar Urban dhe Turizmit (PZHIUT): me 12 projekte;*
- *Programi i Rrugëve Lidhëse Rajonale dhe Lokale: me 6 projekte;*
- *Programi i Ujësjellësve Ruralë (KfW): me 3 projekte.*



Gjatë këtij viti, në zbatim të legjislacioni shqiptar për pajisjen me lejet përkatëse të të gjitha projekteve, FSHZH ka aplikuar për të bërë të mundur plotësimin e të gjithë dokumentacionit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (VNM), leje mjedisi, leje ndërtimi, Vlerësimin e Impaktit Social, Ruajtjen dhe Sigurinë në Punë, për **111 objekte** (nga të cilat **75 leje** të miratuara, **35 në proces** miratimi dhe **1 objekt** në proces për plotësim dokumentacioni për aplikim), përkatësisht sipas programeve të investimit:

- *Programi i Ndërhyrjeve të Financuara nga Buxheti i Shtetit (GoA & IVR):* me **45 leje** të miratuara dhe **24 në proces** miratimi;
- *Programi i Ujësjellësave Ruralë (KfW):* me **6 leje** të miratuara dhe **3** në proces miratimi;
- *Programi i Zhvillimit të Integruar Urban dhe Turizmit (PZHIUT):* me **9 leje** të miratuara dhe **8** në proces miratimi;
- *Programi i Rrugëve Lidhëse Rajonale dhe Lokale:* me **4 leje** të miratuara;
- *Programi për Rindërtim dhe Zhvillim në Zonat e Prekura nga Tërmeti:* **10 leje** të miratuara;
- *Programi i Bashkëpunimit ndërkufitar:* me **1 leje** të miratuar.

### ► Ndjekja e Projekteve në Zbatim

Gjatë vitit 2022 kanë qenë në proces dhe janë ndjekur punimet e zbatimit të projekteve për zhvillim, për rreth **270 objekte** (prej të cilave **81 objekte** kanë përfunduar punimet), të ndara sipas programeve:

- *Programi i Ndërhyrjeve të Financuara nga Buxheti i Shtetit (GoA & IVR):* me **207** objekte
  - Në proces zbatimi të punimeve: 144 objekte
  - Përfunduar punimet: 63 objekte
- *Programi i Ndërhyrjeve të Financuara nga fonde të huaja:* me **26** objekte
  - Në proces zbatimi: 20 objekte
  - Përfunduar punimet: 6 objekte
- *Programi për Rindërtim dhe Zhvillim në Zonat e Prekura nga Tërmeti:* me **37** objekte (përkatësisht 2 objekte arsimore, 5 banesa individuale, 11 objekte infrastrukturë publike, 19 objekte kolektive)
  - Në proces zbatimi: 25 objekte
  - Përfunduar punimet: 12 objekte

Gjatë këtij viti, FSHZH ka bërë përmirësime në projekt-preventiv për 53 objekte dhe inspektime në terren për të kontrolluar cilësinë e punimeve dhe mobilizimin në kantier/ecurinë e punimeve për të gjitha objektet në proces zbatimi.

### ► Dorëzimet, Kolaudimet, Dhënia në përdorim e objekteve

Për **539 objekte**, janë dorëzuar tek Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore 9 objekte duke nënshkruar Certifikatat e Marrjes në Dorëzim Përfundimtar dhe 515 objekte duke nënshkruar Certifikatat e Marrjes në Dorëzim të Përkohshëm.

Gjithashtu, gjatë 2022 janë monitoruar për defekte të mundshme sipas afatit të garancisë rreth 15 objekte dhe është bërë transferimi i investimit në NJVV sipas VKM-ve përkatëse për 93 objekte të Programit për Rindërtim dhe Zhvillim në Zonat e Prekura nga Tërmeti.

Informacion mbi objektet e përfunduara sipas statusit dhe programit të investimit					
Programi	Numri i objekteve	Objekte të monitoruar për defekte gjatë periudhës së garancisë	Objekte të dorëzuar		Objekte për të cilët ka dalë VKM e Transferimit të Investimit
			Përkohshëm	Përfundimtar	
Programi i Ndërhyrjeve të Financuara nga Buxheti i Shtetit	87	12	65	7	-
Programi i Ndërhyrjeve të Financuara nga fonde të huaja	14	3	12	2	-
Programi për Rindërtim dhe Zhvillim në Zonat e Prekura nga Tërmeti	438	-	438	-	93
<b>Total</b>	<b>539</b>	<b>15</b>	<b>515</b>	<b>9</b>	<b>93</b>

### 3.5. REALIZIMI I BUXHETIT

Në kuadër të objektivave të Garantimit të Financimit, Programit Operacional 2022-2028 të FSHZH-së mbi zhvillimin rajonal dhe kohezionin, nëpërmjet përdorimit ekonomik dhe eficient të financave, është mundur:

- Mirë-menaxhimi financiar për realizimin e buxhetit 2022;
- Garantimi i likuidimit të detyrimeve ndaj të tretëve në kohë dhe me cilësi;
- Detajimi i financimit për projektet ekzistuese dhe të reja në përputhje me limitet e financimit;
- Identifikimi i burimeve të reja të financimit nëpërmjet komunikimit me aktorë të jashtëm (institucione financiare ndërkombëtare, banka të nivelit të dytë, etj.).

Gjatë vitit 2022, FSHZH ka pasur në zbatim 11 programe/projekte me financim të huaj dhe 4 programe me financim të brendshëm. Në total, **buxheti i vitit 2022, është realizuar në masën 99.41%**. Në zbatim të Ligjit nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, si dhe mbështetur në detajimin e buxhetit për vitet 2022-2024 miratuar me shkresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 22922/245 prot., datë 3.3.2022, rezulton se buxheti i FSHZH-së ka pësuar disa ndryshime si efekt i akteve normative apo vendimeve të Këshillit të Ministrave. Konkretisht, gjatë vitit 2022 kanë ndodhur ndryshime si rezultat i AN nr. 3, datë 12.3.2022; AN nr. 12, datë 29.7.2022; AN nr. 17, datë



1.12.2022; AN nr. 19, datë 29.12.2022. Si rezultat i ndryshimeve të mësipërme, buxheti i rishikuar i FSHZH-së bëhet **23.56 miliardë lekë** nga të cilat realizuar **23.42 miliardë lekë**, ndarë sipas programeve:

- me Financim të Huaj:  
5.89 miliardë ALL
- me Financim të Brendshëm:  
9.69 miliardë ALL
- Programi i Rindërtimit:  
7.83 miliardë ALL

Burimet e Financimit	Buxheti 2022 (miliardë lekë)	Realizim Buxheti 2022 (miliardë lekë)	Realizim Buxheti 2022 (%)
Investime të Huaja	5.92	5.89	99%
Investime të Brendshme (Qeveria Shqiptare)	6.64	6.58	99%
Investime të Infrastruktura Vendore Rajonale	3.05	3.01	99%
Investime, Programi «100 Fshatrat»	0.1	0.1	100%
Investime, Programi i Rindërtimit	7.85	7.84	100%
<b>Total Buxheti</b>	<b>23.56</b>	<b>23.42</b>	<b>99.4%</b>

Për buxhetin 2022, janë kryer mbi **6,000 transaksione financiare** duke garantuar shlyerjen në kohë të detyrimeve kontraktuale ndaj të tretëve.

Gjatë 2022 u finalizua negociimi dhe nënshkrimi i marrëveshjeve të reja me financim të huaj, si:

- Programi i Zhvillimit Rajonal, financuar nga KfW;
- Programi Porta e Alpeve, financuar nga BEI;
- Programi i Rindërtimit, financuar nga KfW;
- Programi për Zhvillimin e Integruar Urban dhe Turizmin, marrëveshja shtesë financuar nga Banka Botërore;
- Programi i Rehabilitimit të Rrugës Vlorë-Radhimë-Orikum, janë finalizuar procedurat dhe praktikat e financimit me Fondin Saudit.

Gjatë këtij viti, në zbatim të udhëzimeve të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, janë përgatitur Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin ushtrimor 2021.

Kompania e auditimit të jashtëm Grant Thornton, e përzgjedhur nga MFE, ka mbyllur procesin e auditimit për vitin ushtrimor financiar 2020 dhe në muajin Maj 2022 ka dorëzuar pasqyrat financiare për çdo program si dhe raportin përfundimtar të konsoliduar.

Pranë Bankës Botërore janë dërguar draftet e pasqyrave financiare për auditimin e jashtëm për vitin ushtrimor 2021 dhe po vijon procesi me përgatitjen e drafteve për pasqyrat financiare për çdo program për t'u përcjellë pranë audituesit të jashtëm të përzgjedhur nga MFE, në cilësinë e institucionit që kryen përzgjedhjen e kompanisë audituese.

Në janar 2023 është dërguar në MFE dhe detajimi sipas programeve dhe limitit buxhetor të miratuar për vitet 2023-2025.

Përgjatë vitit 2022 është raportuar në mënyrë periodike në MFE pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit dhe Drejtorisë së Borxhit, njëkohësisht janë dërguar raportet periodike të raportimit pranë Bankës Botërore, KfW dhe BERZH në përputhje me formatet sipas marrëveshjeve respektive lidhur me burimin dhe përdorimin e fondeve.

### 3.6. PROCEDURAT E PROKURIMIT

Gjatë vitit 2022 janë ndjekur dhe zhvilluar gjithsej **260 procedura prokurimi**. Nga këto, peshën kryesore e zënë procedurat për “Shërbim/Shërbim Konsulence” dhe ato për “Punë”, respektivisht me 121 dhe 104 procedura, si dhe 35 procedura për blerje “Mallrash”, të zhvilluara dhe finalizuara me nënshkrimin e kontratave përkatëse.

Në lidhje me investimet e financuara nga QSH, fokusi dhe vëmendja e punës së prokurimeve gjatë kësaj periudhe ka vijuar të jetë e lidhur me *Programin e Projekteve Prioritare të QSH, atë të Infrastrukturës Vendore Rajonale, Programin 100 Fshatrat, si dhe Programin për Rindërtim dhe Zhvillim në Zonat e Prekura nga Tërmeti*.

Ndërkohë, ka vijuar puna dhe me procedurat në zbatim të programeve me financim të huaj, ku vlen të përmenden aktivitetet e *Programit për Zhvillimin e Integruar Infrastrukturor dhe Turizmin* financiar nga fondet e Bankës Botërore, BERZH dhe BE, apo ato të *Programit të Furnizimit me Ujë në Zonat Rurale (III & IV)*, financiar nga Banka Gjermane KfW.

Përsa i përket vlerës së kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2022, rezulton se në total janë rreth **21,5 mld lekë** me tvsh të përfshira në këto kontrata. Rreth **51%** të kësaj vlere, e zënë kontratat e nënshkruara në zbatim të programit të investimeve të QSH dhe rreth **49%** kontratat e nënshkruara në zbatim të programeve të financimit të huaj.

#### ► Pjesëmarrja e arritur në procedurat e prokurimit

Referuar numrit të procedurave të ndjekura, interesi i operatorëve ekonomikë për pjesëmarrje në procedurat e prokurimit të zhvilluara gjatë vitit 2022, rezulton të ketë qenë i konsiderueshëm. Kështu, numri mesatar i operatorëve pjesëmarrës në procedurat e prokurimit dhe ai i operatorëve ekonomikë të kualifikuar, paraqitet si më poshtë:

- ✓ *Për Programet e Investimeve të Qeverisë Shqiptare*: pjesëmarrja rezulton të jetë mesatarisht **18 OE** për procedurë, nga të cilët numri mesatar i OE të kualifikuar është rreth **15**, shifër që përbën rreth **83%** të pjesëmarrësve.
- ✓ *Për Programet/Projektet me financim të huaj*: pjesëmarrja rezulton të jetë mesatarisht **6 OE** për procedurë, nga të cilët numri mesatar i OE të kualifikuar është rreth **4**, shifër që përbën rreth **67%** të pjesëmarrësve.

#### ► Përdorimi i fondeve (uljet mesatare/kursimet)

Referuar procedurave të prokurimit të cilat kanë konkluduar me kontrata të nënshkruara, rezulton se, nga Fondi Limit prej rreth **28.55 mld Lekë** me tvsh, janë **kursyer rreth 7.05 mld lekë** me tvsh, të cilat përbëjnë rreth **24.7%** të fondit total të shpallur për tenderim.

#### ► Procesi i ankimimit në procedurat e prokurimit

Përsa i përket procesit të ankimimit, duke marrë në konsideratë numrin e konsiderueshëm të procedurave të zhvilluara, rezulton se numri i rasteve ku janë paraqitur ankesa nga OE të interesuar, të cilat lidhen me vendimet e marra nga ana e AK gjatë vitit 2022, është shumë i ulët. Konkretisht nga **260** procedura të zhvilluara, rezultojnë të jenë paraqitur në total **vetëm 2 raste**

ankesash pranë FSHZH, të cilat janë drejtuar nga ana e OE edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik. Ankesat kanë qenë të lidhura me procedura të ndjekura në zbatim të *programeve me financim të brendshëm*. Si rezultat i shqyrtimit të tyre, rezultojnë se për të dy rastet, vendimi i marrë nga FSHZH është pranuar dhe është rrëzuar në shkallën e dytë të ankimit (KPP). Ndërsa për procedurat e prokurimit të zhvilluara në zbatim të *programeve/projekteve me financim të huaj*, nuk ka pasur asnjë ankesë të depozituar pranë FSHZH.

Në çdo rast, FSHZH ka qenë aktive në dhënien e përgjigjeve, kur operatorë të interesuar kanë drejtuar pyetje apo kërkesa për sqarime lidhur me procedurat e ndjekura.


### 3.7. RREGULLATORI

Referuar garantimit të ligjshmërisë dhe rregullimit të marrëdhënieve, gjatë vitit 2022 janë ndjekur në bashkëpunim me ministritë e linjës dhe institucionet përkatëse, **miratimet e 10 akteve** ligjore/nënligjore, të cilat lidhen me veprimtarinë e FSHZH-së, konkretisht: 4 akte të miratuara mbi financimet e huaja; 1 akt për ZHRK, 4 akte mbi shpronësimin/shkëmbimin në funksion të procesit të rindërtimit, si dhe 2 akte për kalimin e përgjegjësisë së administrimit të dy pronave (në Korçë dhe Lundër/Tiranë) në favor të FSHZH-së.

Janë hartuar marrëveshjet për projektet e reja me NJVV, si marrëveshjet e investimit, bashkë-investimit dhe sipërmarrjeve për zhvillim, apo ato të furnizimit me lëndë të parë. Gjithashtu, është dhënë mbështetje e nevojshme për ngritjen, regjistrimin dhe fillimin e operimit të subjekteve të miratuara me VKD (AMI dhe HUBEX), duke hartuar edhe draftet për këtë qëllim.

Deri në Dhjetor 2022, rezultojnë gjithsej 60 procese gjyqësore. 12 procese gjyqësore të reja janë hapur gjatë vitit 2022 (në 10 prej tyre FSHZH është pala e paditur dhe në 2 është person i tretë). 9 vendime gjyqësore janë dhënë në vitin 2022, nga ku: (i) 4 vendime në favor të FSHZH; (ii) 3 padi janë pranuar pjesërisht (*1 marrëdhënie pune e transferuar nga AZHER dhe e ankimuar; 2 mbi shpronësimin me detyrim solidar bashki+KM+FSHZH dhe 1 me bashki+ARRSH, që lidhen kryesisht me metodën e vlerësimit të shpronësimit gjatë procesit të rindërtimit*); (iii) 2 kërkesë padi të pranuar plotësisht (*1 çështje e transferuar nga AZHER, tjetra rekomandim KLSH, ankimuar*).

Paraqitja grafike në vite e proceseve gjyqësore sipas objektit të gjykimit, paraqitet si vijon:



## 4. TRANSFORMIMI I ZHVILLIMIT DHE KOHEZIONIT RAJONAL

### 4.1. ZHVILLIMI I APLIKUAR

Me qëllim realizimin dhe implementimin e projekteve transformuese dhe inovatore që nxisin zhvillimin e modeleve të reja të suksesshme, bazuar në zhvillimin rajonal, kohezion dhe partneritete, është ngritur posaçërisht Departamenti i Zhvillimit të Aplikuar dhe Partneritetit, i cili ka në përbërje Inkubatorin e Modeleve të Aplikuara të Zhvillimit (IMAZH) dhe koordinon punën dhe veprimtarinë e 4 operatorëve të zhvillimit të aplikuar (AEM, AMI, HUBEX, Agregatori), të ngritur sipas vendimeve të Këshillit Drejtues të FSHZH, funksionimi i të cilëve rregullohet nga kuadri ligjor për shoqëritë tregtare dhe *OJF*-të.

IMAZH është ngritur sipas procesit të riorganizimit strukturor të FSHZH në fund të 3 muorit të parë të vitit 2022, si pjesë e Departamentit të Zhvillimit të Aplikuar dhe Partneritetit, dhe ka në përbërjen e tij dy njësi, atë të Inovacionit dhe atë të Transformimit, duke patur funksion formësimin e modeleve të ndryshme inovative, duke konceptuar dhe përgatitur studime fizibiliteti dhe plane biznesi për një sërë projektsh.

Pavarësisht se IMAZH ka filluar të bëhet funksionale si strukturë në Shtator 2022 (plotësuar me staf definitiv në përfundim të tremujorit të tretë), kjo nuk ka ndikuar në punën dhe dhënien e rezultateve të konsiderueshme, duke filluar me ngritjen e një sërë koncept-projektsh, *'business case'*, planeve të biznesit apo studimeve të fizibilitetit, të cilat në rast miratimi, vijojnë të implementohen nga 4 operatorët (AEM, AMI, HUBEX, Agregatori), sipas fushave të tyre të veprimtarisë. Në mënyrë të përmblodhur më poshtë paraqiten të dhënat:

Sasia	Kategoritë	Përshkrim produkti
16	Analiza	<i>procese analizash territoriale si edhe të formave të tjera sipas rasteve, referuar madhësisë së tregjeve, turistëve, subjekteve tregtare, kërkimit të tregjeve huaja, etj.</i>
14	Koncept Ide	<i>koncepte zhvillimi të ndryshme në fushat e turizmit, infrastrukturës, ekselencës teknologjike, asaj të ndërtimitarisë, energjisë, administrimit të aseteve, etj.</i>
9	'Business Case'	<i>parafizibilitete të gjeneruara/aprovuara mbi koncept idetë e paraqitura në turizëm, infrastrukturë, energji, ICT dhe ndërtimtari, në format e administrimit të aseteve, etj.</i>
4	Plane Biznesi	<i>fizibilitete në fushat e infrastrukturës së parkimeve dhe energjisë së gjelbër</i>

### 4.2. OPERATORËT E SHËRBIMEVE

FSHZH që prej vitit 2018 ka ngritur dhe vënë në funksionim operatorin e zhvillimit të aplikuar **AEM**, si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në funksion të aktiviteteve ekonomike të caktuar për të incentivuar dhe ngritur modele zhvillimi në zona me potencial të lartë. Në Shtator 2022 u regjistruan dhe filluan funksionimin edhe dy operatorë të tjerë zhvillimi: **AMI** me fokus manaxhimin dhe administrimin e aseteve dhe **HUBEX** si një qendër ekselence për inovacion, teknologji dhe ngritje kapacitetesh. Aktualisht është në fazë ngritje dhe operatori i 4-ërt, **Agregatori**, si një qendër për ngritjen e partneritetit në rajonet e zhvillimit dhe mbi bashkëpunimin për mirëqeverisje me njësitë e vetëqeverisjes vendore.



Në lidhje me katër operatorët ekonomikë të FSHZH-së, është punuar për të transferuar (*outsourcing*) pranë tyre disa prej shërbimeve apo proceseve që kryhen në organizatë, me qëllim rritjen e efektivitetit dhe cilësisë së shërbimit. Veprimtaria e tyre gjatë 2022 ka shënuar këto momente kryesore:

► “Agjencia Ekonomike Mbështetëse – AEM” (sh.p.k.), vazhdon të jetë funksionale që nga 2018,





duke konsoliduar aktivitetin pothuajse 5-vjeçar sipas objektivit të veprimtarisë. Aktiviteti ekonomik 2022 mbështetet në misionin dhe objektivat e AEM sh.p.k. të cilat u përmbushën me rezultat pozitiv financiar

në fund të këtij viti ushtrimor (pa humbje), me fokus në ofrimin e shërbimeve publike të mëposhtme:


- **Fusha e transportit**
  - Manaxhimi i shërbimit Parkim Publik dhe administrimi i territorit të QSUNT, Tiranë;
  - Manaxhimi i shërbimit Parkim Publik në territorin e QMSHSR Tiranë.
- **Fusha e Mikpritjes**
  - Manaxhimi dhe operimi i Qendrës së Zhvillimit të Turizmit, Valbonë;
  - Manaxhimi dhe operimi i Qendrës së Akomodimit Rural, Vermosh.

Përmes aktivitetit ekonomik të zhvilluar gjatë vitit 2022, shoqëria arriti të siguronte të Ardhura në vlerën **130,018 mijë Lekë** ose **16% më shumë se viti 2021**. Grafiku pasqyron nivelin krahasues të të ardhurave gjatë pesë viteve të aktivitetit ekonomik të AEM sh.p.k. 2018-2022.



Realizimi i të ardhurave është në nivelin **94%** të planifikimit fillestar. Përsa i përket fushës së transportit, aktiviteti i ushtruar paraqiti një performancë shumë të mirë duke tejkaluar me **6%** parashikimin e të ardhurave. Edhe për vitin 2022, projektet në fushën e transportit paraqesin burimin kryesor të të ardhurave (grafiku tregon peshën specifike sipas aktivitetit ekonomik).

Niveli i miratuar i shpenzimeve për vitin 2022 ka qenë në vlerën 128,913 mijë Lekë, ndërsa realizimi i tyre ka qenë në vlerën **118,874 mijë Lekë** ose në nivelin **92%**. Grafiku paraqet raportin ndërmjet të ardhurave të realizuara dhe shpenzimeve të kryera përgjatë vitit 2022:





Gjithashtu është planifikuar, për vitin 2023, kalimi i menaxhimit dhe ofrimit të shërbimit të transportit për FSHZH-në, duke synuar aplikimin e një modeli të integruar dhe eficient. Këtu përfshihet shërbimi i transportit në kuadër të aktivitetit të FSHZH-së dhe projekteve që implementon, duke vënë në gadishmëri të plotë drejtuesit dhe mjetet, mirëmbajtjen e tyre, duke siguruar një udhëtim të sigurt dhe në përputhje me rregullat dhe legjislacionin në fuqi

► **“Agjencia e Menaxhimit të Investimeve – AMI” (sh.p.k.),** e fokusuar në investimin dhe



administrimin e aseteve godina, ofrimin e shërbimeve të menaxhimit për asetet e investuara të FSHZH (pastrim, utilitete, siguri dhe informacion, mirëmbajtje), etj. Referuar nisjes së operimit të AMI-t, u përgatit modeli i aplikuar duke parashikuar kryerjen e aktiviteteve/shërbimeve fillimisht vetëm për menaxhimin e godinës së FSHZH-së dhe buxhetin përkatës për këtë shërbim.

► **“HUBEX - Qendra e Ekselencës për Dije dhe Inovacion” (ojf),** e fokusuar në aplikimin e



praktikave më të mira dhe ideve inovative në fushën e teknologjisë dhe asaj të ngritjes së kapaciteteve, si qendër ekselence ICT, investim dhe menaxhim i rrjeteve, aseteve dhe platformave, apo ofrimit të shërbimeve të teknologjisë së informacionit. Referuar nisjes së operimit të HUBEX-it, u përgatit modeli i aplikuar duke parashikuar kryerjen e aktiviteteve/shërbimeve fillimisht vetëm për menaxhimin e disa shërbimeve të IT të godinës së FSHZH dhe buxhetin përkatës për këtë shërbim.

Për të dy subjektet e mësipërm, gjatë 3-mujorit të fundit të 2022, u ndoqën të gjitha procedurat për regjistrimin dhe deklarimet pranë organeve tatimore, taksave vendore, pajisjen me vulë, me llogari bankare, hartimin e objektivave, si edhe planifikimin për vitin 2023 dhe përpilimin e dokumenteve të nevojshëm për garantimin e funksionimit në të ardhmen (*draft strukturat, grilat e pagave, buxheti etj.*), duke përfshirë ngritjen dhe funksionimin e zyrave nga ana logjistike.

► **“AGREGATORI - Qendra për Zhvillim, Partneritet dhe Mirëqeverisje” (ojf),** ende në proces



ngritje (aktualisht në fazë regjistrimi pranë Gjykatës), do të jetë i fokusuar në krijimin e partneriteteve për mirëqeverisje. Fusha dhe veprimtaria e qendrës do të përqendrohet në ngritjen e partneriteteve, formësimin / bërjen bashkë të grupeve të interesit (organizma të partneritetit ekonomik); duke përfshirë rrjetëzimin, ofrimin e mundësive për lobim e promovim të tyre; ofrimi i këshillimit dhe ekspertizës, në bashkëpunim dhe me mbështetjen e njësisë të vetëqeverisjes vendore, për bashkimin në organizma kolektive më të mëdhenj (shoqata), të cilat do të kenë si anëtarësi bizneset që operojnë në një fushë, industri apo sektor të caktuar; konsultimin me publikun/ grupet e interesit për shkëmbimin e ideve në funksion të zhvillimit rajonal dhe zhvillimit të aplikuar sipas zonave dhe fushave të ndërhyrjeve; organizimin e eventeve për bashkëpunim dhe socializim të grupeve të ndryshëm të interesit në nivel rajonal/vendor; etj.

## 5. PËRPUTHSHMËRIA DHE TRANSPARENCA

### 5.1. KONTROLLI DHE PËRPUTHSHMËRIA E AKTIVITETIT

Përgjatë vitit 2022, Njësia e Auditimit të Brendshëm, ka synuar me misionin e saj të japë në mënyrë të pavarur siguri të arsyeshme dhe të ofrojë këshillime për të shtuar vlerë dhe për të përmirësuar sistemet e menaxhimit të projekteve dhe kontrolleve të brendshme në FSHZH, në përputhje me planin strategjik dhe vjetor *fleksibël* të auditimit të miratuar në Këshillin Drejtues në 2022, si dhe duke u bazuar në kërkesa për angazhime këshillimi të iniciuara nga DE, me prioritet për përmirësimin e proceseve të kontrollit dhe menaxhimit të riskut për aktivitetin e FSHZH-së.

Referencë është legjislacioni në fuqi mbi Auditimin e Brendshëm, në rastet e aplikueshme nga FSHZH si organizatë jofitimprurëse e krijuar me ligj të veçantë, duke u bazuar në: (i) Ligjin nr. 10130, datë 11.5.2009, “Për Fondin Shqiptar të Zhvillimit”, i ndryshuar; (ii) Manualin e Procedurave të FSHZH; (iii) Marrëveshjet e financimit me donatorët si dhe marrëveshjet e projekt/programeve; (iv) Vendimet e Këshillit Drejtues dhe të DE; (v) Standardet Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm të miratuar nga IIA. Duke konsideruar natyrën e veçantë të FSHZH, që ndryshe nga institucionet buxhetore të sektorit publik, ka në veprimtarinë e saj menaxhimin e programeve të financuara nga burime të ndryshme (si Qeveria Shqiptare dhe nga Donatorët), ajo është subjekt auditimi nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, Misionet e Donatorëve dhe Ministria e Financave përsa i përket pasqyrave financiare.

Gjatë 2022 është koordinuar në mënyrë efektive komunikimi dhe shkëmbimi i informacionit të nevojshëm për **katër misionet e auditimit nga KLSH**:

- Auditim Financiar dhe Përputhshmërie me objekt “Veprimtaria e Fondit Shqiptar të Zhvillimit” për vitet 2019-2021;
- Auditim përputhshmërie me objekt “Rehabilitimi i Rrugës së Lumit të Vlorës”;
- Auditim përputhshmërie për projektet “Konektiviteti i rrugëve rajonale dhe lokale”, “Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale III”, “Zhvillimi i Integruar Urban dhe i Turizmit”, mbi verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e vitit 2021;
- Auditimin tematik për segmentin “Rikonstruksioni i rrugës Ujë i Ftohtë-Orikum dhe ndërtimi i 2 bypass-ve”, projekti “Konektiviteti i rrugëve rajonale dhe lokale”.

Gjatë vitit të kaluar, FSHZH ka qenë **subjekt auditimi për 2 misionet e Bankës Botërore**:

- për Projektin e Zhvillimit të Integruar Urban dhe Turistik (datë 5-14 Tetor 2022);
- mbi Raportin e shqyrtimit të prokurimeve për PZHIUT (mars 2022).

Gjithashtu, **subjekt auditimi për fondet IPA**:

- Për auditimin e projektit 4Helix+ nga auditori i jashtëm EY i përzgjedhur nga Autoriteti menaxhues i programit Interreg MED;
- Për Auditimin e Projektit IMPRECO nga Agjencia e Auditimit e Bashkimit Evropian për Interreg Adrion Transnacional Cooperation Program.

Në kuadër të standardeve të auditimit për “Dublimin minimal të të gjitha planifikimeve/misionet të shërbimeve, duke minimizuar mbivendosjet” përkundrejt auditimeve të KLSH-së, gjatë 2022 NJAB realizoi misionet e mëposhtme të angazhimit të këshillimit apo tematik të kërkuara nga DE:

- Mbi vlerësimin e cilësisë së zbatimit të punimeve të projektit: “Zhvillimi i atraksionit turistik mbështetur mbi potenciale lokale; 1. Ura Vajgurorë; 2. Zona e Dumresë; 3. Çorovodë Poliçan; 4. Parku Kombëtar Shebenik-Jabllanicë, si dhe testim me prova laboratorike në terren (pjesë e programit IVR financuar nga Qeveria Shqiptare);
- Mbi vlerësimin e cilësisë së zbatimit të punimeve të projektit: “Rikonstruksioni i segmentit rrugor “Peshkëpi -hyrje e Qytetit Selenicë””;
- Mbi vlerësimin e cilësisë së zbatimit të punimeve të RDPA: “Programi i Zhvillimit Rajonal në Shqipëri për zbatimin e Granteve, në mbështetje të zonave të prekura nga tërmeti”;
- Mbi zbatimin e kontratave të Mbikqyrjes gjatë procesit të zbatimit të punimeve të ndërtimit për projekte në zbatim.

Testimi i plotshmërisë dhe saktësisë së dokumentacionit teknik e financiar i shoqëruar me inspektim të thelluar të punimeve në terren apo me prova laboratorike, ndihmoi për të përcaktuar mundësitë dhe mënyrat për përmirësimin e procedurave, rregullave e praktikave të punës për zbatimin optimal të projekteve, si dhe përdorimin me efektivitet dhe ekonomi të fondeve të marrëveshjeve të financimit. Gjithashtu angazhime të tjera të NJAB gjatë 2022 përfshijnë:

- Hartimi i Planit Strategjik dhe Vjetor 2023-2025 të NJAB, sipas kërkesës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Harmonizimit të Auditit të Brendshëm (tetor 2022);
- Hartim i raportit vjetor 2021 të NJAB sipas kërkesës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Harmonizimit të Auditit të Brendshëm (shkurt 2022);
- Koordinimi i punës mbi programin e kontrollit për njësinë Përgjegjëse të Sinjalizimit të Brendshëm në Autoritetet Publike, nga ILDKPKI;
- Trajnimi i vijueshëm profesional organizuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë për stafin e Auditimit të Brendshëm;
- Certifikimi i Audituesve të Brendshëm në sektorin Publik për sezonin 2022-2023, organizuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, për stafin e Auditimit të Brendshëm.

## 5.2. AKTORËT DHE PARTNERËT PËR ZHVILLIM

Gjatë 2022, FSHZH ka vijuar marrëdhëniet e saj me një numër të madh aktorësh dhe partnerësh për zhvillim sipas kategorive kryesore:

- Marrëdhëniet me Qeverisjen Qendore, ku veçojmë marrëdhëniet dhe komunikimin e vazhdueshëm me Zyrën e Zëvendëskryeministrit, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Ministrinë e Mjedisit dhe Turizmit, etj., marrëdhënie që lidhen me përcaktimin e prioriteteve, hartimin dhe miratimin e akteve ligjore e nënligjore, si dhe financimin e programeve zhvillimore, etj.
- Marrëdhëniet me Institucionet Ndërkombëtare Financiare të cilat financojnë programe të ndryshme zhvillimi bazuar në marrëveshjet e huave apo të granteve, ku veçojmë, BB, BERZH, KfW, Fondi Kuvajtian, Fondi Saudit, etj.

- Marrëdhëniet me institucionet e tjera qendore, të cilat lidhen apo kanë përgjegjësi të ndryshme në funksion të realizimit të projekteve zhvillimore, si AKPT, Instituti i Ndërtimit, ARRS, AKUM, OSSHE, AZHT, etj.
- Marrëdhëniet me Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, ku aktiviteti i FSHZH-së ka pasur ndërveprim të vazhdueshëm pothuajse me të gjitha NJVV-të, në funksion të realizimit të projekteve të ndryshme dhe detyrimeve të ndërsjellta sipas marrëveshjeve të investimeve dhe që lidhen kryesisht me pajisjet me leje, shpronësimet, adresimit të problematikave sociale, monitorimin e investimeve dhe marrjen në dorëzim prej tyre, si përfituesit kryesorë të këtyre investimeve, por edhe si partnerë në investimet e reja.

Gjatë 2022, u realizua procesi i vlerësimit të jashtëm të performancës së organizatës në periudha 3-mujore, ku përfshihet vlerësimi pozitiv prej 4.4 pikësh (nga 5 max) në Qershor 2022, dhënë nga partnerët financiarë kryesorë të FSHZH, nga 50 Kryetarë të NJVV-ve dhe rreth 30 kontraktorë.

Në bashkëpunim me zyrat rajonale të zhvillimit në 4 rajonet, gjatë 2022 janë kryer disa vlerësime mbi impaktin e investimeve të ndryshme të realizuara në Shqipëri, nëpërmjet pyetësorëve të dedikuar për kategori të ndryshme përfituesish të drejtpërdrejtë, ku: (i) Tetor 2022 - vlerësim me 3.7 pikë prej 197 personave mbi projektet përfaqësuese të zbatuara në Vlorë, Berat, Durrës, Kukës; dhe (ii) Dhjetor 2022 - vlerësim me 4 pikë prej 206 personave mbi projektet përfaqësuese në Shkodër/Shirokë, Krujë/Thumanë, Fier/Roskovec/Poshnje, Korçë/Ersekë/Berat/Elbasan.

### 5.3. TRANSPARENCA DHE KOMUNIKIMI ME PUBLIKUN

FSHZH ka vijuar punën për të koordinuar në mënyrë efektive komunikimin e brendshëm dhe të jashtëm, duke kontribuar në konsolidimin e imazhit të FSHZH përballë palëve të treta dhe mbajtjen e marrëdhënieve optimale me aktorët e interesit, nëpërmjet bashkëpunimit me strukturat e ndryshme. Gjatë 2022, janë administruar 347 ankesa/kërkesa për informacion nga qytetarë, media, zyra avokatie, gazetarë, të deleguara nga Platforma e Bashkëqeverisjes ose NJVV, në lidhje me projektet që FSHZH implementon në të gjithë vendin. Gjithashtu, FSHZH mban korrespondencë edhe me Ministrinë e linjës, Agjenci, etj. mbi ecurinë e objekteve në zbatim, dorëzimet e objekteve të përfunduara si dhe informacion për projektet që pritet të zbatohen.

Faqja zyrtare web gjatë kësaj periudhe ka pasur 246,165 shikime. Gjatë vitit 2022, në rubrikën “Info dhe Lajme” në faqen e Internetit janë publikuar 31 artikuj të shkruar në gjuhën shqipe dhe angleze, me fokus në projektet e reja dhe projektet në zbatim. Janë realizuar gjithsej 16 materiale vizuale për prezantimin e ecurisë së punimeve dhe prezantimin e objekteve të përfunduara, pjesë e programeve të ndryshme. Shikueshmëria për këto materiale audiovizuale të përgatitura në total është rreth 1,800,000 shikime me një mesatare prej rreth 115,000 shikime/material audiovizual.

Platformat e komunikimit online si: Facebook, Instagram, LinkedIn, YouTube dhe faqja zyrtare web, janë përdorur si një instrument për të konsoliduar pozitivisht reputacionin dhe imazhin e organizatës.

Të dhënat gjatë 2022 në kanalet zyrtare të FSHZH			
	Facebook	Instagram	LinkedIn
Postime	104	35	17
Ndjekës në total	18,000	3,330	4,363